

Projekti Nr.	Pro-Career
Vendi	Kosovë
Rajoni i projektit	Rajoni i Pejës duke i përfshirë komunat Istog, Deçan, Klinë dhe Gjakovë Rreth 25 shkolla fillore me afro 6570 nxënës të klasës 6-9-të dhe rreth 1700 nxënës të klasës së 9-të
Gjendja fillestare	Vendit akoma i mungon dhe është larg sigurimit të mundësive të mjaftueshme për vendet e punës dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik. Sistemi arsimor në Kosovë përgatitë shumë pak nxënës për tregun e punës. Në moshën e tyre të marrjes së vendimeve për arsimim dhe karrierë, të rinjtë nuk kanë informata të nevojshme as për mundësinë e arsimimit dhe profilet profesionale, e as për vendet e lira të punës dhe perspektivat në tregun e punës. Gjithashtu edhe prindërit – të cilët sipas një sondazhi të Syri I Vizionit ndikojnë në zgjedhjen e arsimimit të mesëm e shumica prej tyre e kanë të njëjtën mungesë të informatave. Disa shkolla fillore kanë filluar të zbatojnë kursin e këshillimit në karrierë, por as shkollat e as komuna nuk kanë një plan pune apo strategji për zhvillimin e këtij kursi. Ministria e Arsimit e Kosovës është duke hartuar dhe testuar një kurrikulë të re por mësimdhënësit nuk janë në gjendje të përballojnë organizimin e këtyre kurseve dhe kanë nevojë për mbështetje shtesë.
Objektivat	<p>Rritja e punësimit të të rinjve në bazë të një zgjedhjeje më të mirë të informuar për karrierën, duke iu referuar aftësive individuale dhe kërkesave të tregut të punës</p> <p>Projekti duhet të trajtojë tri objektiva specifike;</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Inicimin apo përmirësimin e udhëzimeve dhe këshillimeve në karrierë në 25 shkolla fillore, 2. Produktet dhe shërbimet standarde të informimit(udhëzuesit, ueb faqen, panairët e punës etj., që ofrohen dhe kontribuojnë për informimin më të mirë të nxënësve, prindërve dhe arsimtarëve, 3. Kornizën e politikave për udhëzuesin dhe këshilluesin në karrierë që është përmirësuar falë propozimit të politikës së informimit
Rezultatet e pritura	<ol style="list-style-type: none"> 1.1. Rreth 1700 nxënës të klasës së 9-të kanë përfituar nga udhëzuesi dhe këshilluesi i ri i përmirësuar duke përmirësuar kompetencat e tyre vendimtare për arsimim të drejtë dhe për zgjedhjen e karrierës. 1.2. Këshilli i punës për Udhëzim dhe Këshillim në karrierë në Pejë ka përgatitur për së paku 13 shkolla fillore planin lokal të këshillimit në karrierë dhe janë zgjedhur mjetet e punës si dhe është ndarë kapitali njerëzor, 2.1. Masat e përmirësimit të aplikuara nga Këshilli komunal i punës e kanë rritur numrin e regjistrimeve në AAP, 2.2. Rreth 80 mësues të arsimit fillor ,120 prindër dhe rreth 6570 nxënës të klasës 6-9-të kanë një fotografi të qartë mbi profilet profesionale, opsionet e arsimit dhe kompetencat e tyre,

2.3. **Përfshirja e rreth 120 prindërve** në shkollat fillore në këshillimin për karrierë rezultoi i suksesshëm dhe me ndikim në regjistrim në AAP dhe imazhi i arsimit të AAP-së është përmirësuar dhe luan rol të rëndësishëm në formësimin e zhvillimit të karrierës së nxënësve

3.1. Këshilli komunal i punës për udhëzim dhe këshillim në karrierë në arsimin fillor ka përcaktuar së paku **4 koncept dokumente** me rekomandime për përmirësimin e kornizës së politikave mbi udhëzimin dhe këshillimin në i karrierë,

3.2. Këshilli komunal i punës miraton dhe paraqet të paktën **2 raporte monitorimi dhe vlerësimi** për implementimin e modelit të udhëzimit dhe këshillimit në karrierë.

Përfituesit	Së paku 13 shkolla fillore nga 25 shkollat kanë zbatuar udhëzimin dhe këshillimin në karrierë Rreth 6750 nxënës të klasave të 6-ta deri 9-ta dhe rreth 1700 nxënës të klasës së 9-të kanë një njohuri më të mirë për interesat, aftësitë dhe talentet e tij /saj.
Partnerët	Syri i Vizionit filloi me punë që në vitin 1999 si një organizatë që bazohet në komunitet (OBK) në qytetin e Pejës. Në sektorin e arsimit Syri i Vizionit dhe Solidar Suisse në kuadër të projektit Mismatch e kanë krijuar terrenin e këshillimit në karrierë në gjashtë komuna të rajonit perëndimor të Kosovës duke rritur kapacitetet e mësimdhënësve në ofrimin e udhëzimeve në karrierë dhe shërbimeve të këshillimit në shkollat fillore dhe duke mbështetur me materiale dhe mjete të nevojshme për kryerjen e shërbimit CGC. Këshilli komunal i punës është themeluar nëpërmjet projektit Pro-Career si një grup i dialogut publik-privat i përbërë nga menaxhimi i shkollave fillore në Pejë. Drejtoria komunale e arsimit, ofruesit e trajnimit, prindërit dhe përgjegjësit e shkollave të AAP-së në rajonin e Pejës. Fushëveprimi i DKA-së është të promovojë dhe koordinojë shkëmbimin e rregullt ndërmjet aktorëve dhe të veprojë si organ këshillëdhënës për shërbimin e CGC-së në arsimin fillor.
Kohëzgjatja	Data e fillimit dhe përfundimit të projektit janar 2017-dhjetor 2020
Personi përgjegjës dhe uebfaqja	www.syriivizionit.org